



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË GLLOGOCIT PËR VITIN 2024

Prishtinë, maj 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Glllogocit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Glllogocit (GLL), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Glllogocit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Keq klasifikime në kategori të ndryshme ekonomike në vlerë prej 2,488,200€, të cilat janë realizuar përmes ekzekutimit të vendimeve gjyqësore/ përmbarrimore.
- A1 Pasuritë jo kapitale me vlerë nën 1,000€, të raportuara në vlerë prej 454,130€, janë nënvlerësuar për 112,203€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Glllogocit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A2 Vonesa në lëshimin e lejeve ndërtimore.
- A3 Në dy (2) raste ishte bërë përzgjedhja e kontraktueseve (OE) në mungesë të plotësimin të plotë të kriterëve.
- A4 Realizimi i artikujve të kontratës me çmim për njësi, jo në përputhje me peshën e përcaktuara në dosje të tenderit dhe pranimi i shërbimeve të paarsyetuara.
- B2 Mungesa e projekteve ekzekutive.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Glllogocit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Glllogocit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Glllogocit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Glllogocit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Glllogocit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të dukshëm, rreth menaxhimit financiar dhe kontrollin e brendshëm. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare: keq klasifikime të shpenzimeve nga vendimet gjyqësore përmbartimore për zbatimin e kontratës kolektive, në inventarizimin e pasurive, mangësi në pranimin e shërbimeve, mangësi në zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit, tejkalime kontraktuale dhe mangësi në fushën e të hyrave. Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të përmirësojnë informacionin financiar të paraqitur në pasqyrat financiare vjetore, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Gjithashtu duhet të theksojmë se për vitin 2024, Thesari kishte ekzekutuar përmes procedurave gjyqësore përmbartimore që kanë të bëjnë me implementimin e kontratës kolektive në vlerë 3,580,855€ nga te cilat sipas komunës kishte rezultuar në shpenzime shtesë të procedurës 771,724€.

Ky raport ka rezultuar me njëmbëdhjetë (11) rekomandime, prej tyre shtatë (7) janë rekomandime të reja, dhe katër (4) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Keq klasifikim i shpenzimeve

Gjetja

Nenit 18, paragrafi 3 e Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Kemi vërejtur keq klasifikime të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike në vlerë 2,488,200€. Nga kjo vlerë thesari kishte paguar sipas urdhrave përmbartimor për zbatimin e kontratës kolektive nga kategoria e investimeve kapitale 1,879,133€, mallrave dhe shërbimeve 359,344€, subvencioneve dhe transfereve 221,874€ dhe shërbimeve komunale 27,849€.

Pagesat për paga jubilarë dhe shujta kanë ndodhur si rezultat i kontratës kolektive, shpenzimet e të cilave nuk kanë mundur të planifikohen me buxhet.

Ndikimi

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve nga kategoritë ekonomike jo adekuate, ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve dhe të pasurive. Si rrjedhojë ndikon në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në PFV.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridentinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme) dhe që

pagesa e regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Nënvlërësimi i pasurive nën 1,000€

Gjetja Rregullorja MF-Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 6.1. përcakton se, "Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Po ashtu neni 6.3. përcakton se: Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria".

Në regjistrin e pasurive jo financiare nën 1,000€, kemi vërejtur pasuri të blera në vitin 2023 dhe 2024 për 117 njësi për tabela të mençura me vlerë 112,203€, nuk ishin regjistruar në regjistrin e-pasuria që rezulton në nënvlerësimin e regjistrit të pasurive jokapitale.

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të dobëta në monitorimin dhe verifikimin e regjistrave të pasurisë.

Ndikimi Mos regjistrimi i pasurisë, sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren për menaxhimin e pasurisë jo financiare, mund të ndikoj në humbjen a po tjetërsimin e pasurisë dhe prezantimin e informatave jo të plota në pasqyrat financiare vjetore.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare në pajtim me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A2 - Vonesa në lëshimin e lejeve ndërtimore

Gjetja Neni 17 (pika 1.2) i Ligjit të Ndërtimit thotë: "Leja ndërtimore lëshohet nga organi kompetent brenda (30) ditëve pas pranimit të kërkesës për leje ndërtimore për kategorinë I dhe dyzet e pesë (45) ditë për kategoritë II dhe III".

Në dy (2) raste ka vonesa në lëshimin e vendimeve për lejet ndërtimore sipas afatit ligjor nga ana e Komunës pas pranimit të kërkesës për leje ndërtimore. Vlera totale e këtyre mostrave është 100,610€, kurse vonesat në lëshimin e lejeve ndërtimore janë deri 220 ditë.

Kjo ka ndodhur për arsye të mosfunksionimit efektiv të kontrolleve të brendshme dhe vonesat në pëlqimin nga KEDS-i për kompletimin me kohë të dokumentacionit.

Ndikimi Vonesat në lëshimin e lejeve ndërtimore, përveç inkasimit me vonesë të të hyrave, ndikojnë në ligjshmërinë dhe efikasitetin e lëshimit të lejeve ndërtimore.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë që të respektohen afatet ligjore për lëshimin e lejeve ndërtimore, duke forcuar kontrollin e brendshëm dhe mbikëqyrjen mbi trajtimin e kërkesave, në mënyrë që të mundësohet mbledhja me kohë e të hyrave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Shpërblimi më kontratë në mungesë të plotësimit të kriterëve të vendosura në dosjen e tenderit

Gjetja Ligji i prokurimit publik Neni 59 paragrafi 4 parasheh: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, rregullorja 001/2022 për prokurimin publik neni 28.7 parasheh: Afati i fundit për dorëzimin e sigurimit të tenderit do të jetë i njëjti si ai për dorëzimin e tenderëve. Sigurimet e tenderëve të pranuar pas afatit për dorëzimin e tenderit do të refuzohet dhe kështu do të rezultojë në refuzimin e tenderit.

OE të shpërblyer me kontratë në mungesë të plotësimit të kërkesave të njoftimit për kontratë dhe dosje të tenderit po i paraqesim rastet si në vijim:

- Te kontrata për "Ndërtimi, zgjerimi dhe rikonstruimi rrugëve të asfaltuar në Drenas - projekt dy vjeçar (Rrugës tre-katër korsi (Rikonstruimi) Rruga Fehmi dhe Xhevë Lladrovci), në vlerë të kontraktuar 1,018,239€ në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit në kërkesën për përshtatshmëria profesionale pika 6 janë kërkuar raportet e auditimit për tri vitet e fundit 2023, 2022 dhe 2021 ndërsa operatori ekonomik në ofertën e tij ka paraqitur raportet e rishikimit të pasqyrave financiare vjetore; dhe

- Te kontrata për “Ndërtimi i aneksit të SHFMU Rilindja” në Dobroshec në vlerë të kontaktuar 26,978€, operatori ekonomik fitues në ofertën e tij nuk ka dorëzuar sigurinë e tenderit.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së funksionimit të kontrolleve të brendshme, në fushën e prokurimit.

Ndikimi

Kontraktimi i OE pa i përmbushur kriteret e vendosura në dosjen e tenderit, ndikon në transparencën, konkurrencën e procesit të mirëfilltë të prokurimit, dhe mund të ndikoj që kontrata të mos realizohet sipas kushteve të parapara.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në fushën e prokurimit, në mënyrë që vlerësimi i ofertave të bëhet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e vendosura në dosjet e tenderit dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. Po ashtu, përmes zyrtarëve përgjegjës të sigurojë se anëtarët e komisioneve i kuptojnë detyrat dhe përgjegjësitë në procesin e vlerësimit të ofertave përkatëse dhe në rast të gabimeve eventuale këto të evidentohen nga zyrtarët e prokurimit para nënshkrimit të raportit të vlerësimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Realizimi i artikujve të kontratës me çmim për njësi, jo në përputhje me peshën e përcaktuara në dosje të tenderit dhe pranimi i shërbimeve të paarsyetuara

Gjetja

Bazuar në nenin 54.15 të Rregullores 001/2022 dhe interpretimit të KRPP-së të datës 09.06.2023 parasheh: “Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dinë sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshat në bazë të rëndësisë së secilës “kategori të shërbimeve” ose secilit “artikull” në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë për qind (30%), në këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi dhe mund të realizohet deri në vlerë të parashikuar”. Duke pasur parasysh faktin se peshimi i artikujve duhet bërë duke u bazuar në peshën dhe në rëndësinë e çdo artikulli, kjo nënkupton që vlera dhe sasia e realizuar (shpenzuar) e artikujve nuk mund të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë fillimisht në dosjen e tenderit dhe Rregulloja 01/2013/MF- Për shpenzimin e parasë publike, Neni 24, paragrafi 1.2 parasheh: të siguroj raportin e pranimit të mallit/shërbimit nga zyrtari / komisioni i autorizuar.

Kontrata publike kornizë me çmim njësi “Mbështetje profesionale me komponentin e mirëqenies sociale dhe shërbimet publike për qytetaret e komunës së Drenasit” kornizë trevjeçare me çmime për njësi për artikull e çmimin e peshuar 4,94€ me vlerë të parashikuar prej 1,184,440€ e nënshkruar me datën 16.08.2022, ku në të parashihej për artikuj në vijim:

- Artikulli (pozicioni) 3 “Shërbime administrative në koordinimin e punës në fushën e ekonomisë dhe financave, raporteve, dokumentimit, menagjimit si dhe në evidentimin e shërbimeve të kryera sipas standardeve specifike etj” e peshuar me 5% në vitin 2024 bazuar në situacione/fatura të pranuar/ekzekutuara ishin realizuar shërbime në vlerën 95,985€ që ka rezultuar në tejkalim në vlerë 36,763€ dhe artikulli (pozicioni) 7 “Shërbime në koordinimin e punës: raporteve mujore, dokumentimit, menagjimit si dhe në

evidentimin e shërbimeve të kryera sipas standardeve specifike, duke kontrolluar dhe monitoruar stafin etj” e peshuar më 5%, ndërsa ishin pranuar/ekzekutuar shërbime në vlerë 148,797€ që ka rezultuar në tejkalim në vlerë 89,575€.

- Poashtu në testimin për artikullin (pozicioni) 7 “Shërbime në koordinimin e punës: raporteve mujore, dokumentimit, menagjimit si dhe në evidentimin e shërbimeve të kryera sipas standardeve specifike, duke kontrolluar dhe monitoruar stafin etj”, që nënkupton shërbimi për raportet mujore të përgatitura nga të angazhuarit e kompanisë për kryerjen e shërbimeve të kontraktuara, ku në mbështetje të listave të pagave mujore për vitin 2024 për kryerjen e shërbimeve ndaj komunës nga të angazhuarit e kompanisë është 596 paga mujore, që rezulton në ofrimin e shërbimit të raporteve mujore më çmim 27€ që rezulton (arsyeton) vlerën 16,092€ ndërsa faturim/pagesë/situacionet për këtë shërbim në vitin 2024 janë bërë në vlerë 148,797€ e që rezulton në mbi faturim/pagesë/pranim të situacioneve në vlerë 132,705€ të paarsyetuara (fiktive).

Tejkalimi dhe pranimi i shërbimeve të paarsyetuara ka ndodhur si rezultat i mbikëqyrjes së dobët nga ana e menaxherit të kontratës.

Ndikimi

Tejkalimi i shpenzimit të sasive të lejuara sipas peshës që iu është caktuar në dosjen e tenderit dhe në kontratë, ndikon në mungesë të transparencës në vendimmarrjen për zgjedhjen e ofertës me çmimin më të ulët dhe rrit rrezikun e keqpërdorimit të buxhetit si pasoj e pranimi të shërbimeve të paarsyetuara.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të sigurojë se menaxhimi i kontratës nga menaxheri i kontratës bëhet në pajtim me kërkesat ligjore, në mënyrë që kontrata publike kornizë me çmim për njësi të realizohet në pajtueshmëri të plotë me peshën e përcaktuar në dosjen e tenderit dhe pranimi, pagesa e shërbimeve të bëhet sipas shërbimeve reale të ndodhura.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mungesa e projekteve ekzekutuese

Gjetja

Paragrafi 19.17 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik ndër tjerash parasheh se “Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t’i bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit”.

Në shtatë (7) raste komuna kishte filluar procedurat e prokurimit dhe kishte lidhur kontrata pa hartuar projekt ekzekutiv dhe ato ishin si në vijim:

- Projekti për "Ndërtimi i aneksit të SHFMU Rilindja" në Dobroshec me vlerë të kontraktuar 26,975€;
- Projekti për “Asfaltimi i rrugëve në fshatin Sankoc, Fushtice e Epërme dhe e Ulet" lloti II me vlerë të kontraktuar 101,866€;
- Projekti për “Asfaltimi i rrugëve Komoran I II III dhe IV" lloti I me vlerë të kontraktuar 111,222€;
- Projekti për “Asfaltimi i rrugëve dhe kubëzimi Drenasi I II III dhe IV"

- Iloti III me vlerë të kontraktuar 173,280€;
- Projekti për "Asfaltimi i rrugëve në fshatin Nekoc dhe Kishnarek" me vlerë të kontraktuar 139,702€;
 - Projekti për "Rregullimi i trotuarit dhe ndriçimit publik Drenas Komoran Arllat Terstenik Dobroshec dhe Bainsë" me vlerë të kontraktuar 221,970€; dhe
 - Projekti për "Ndërtimi, zgjerimi dhe rikonstruimi i rrugëve të asfaltuara në Drenas" me vlerë të kontraktuar 269,945€.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së planifikimit të duhur para fillimit të procedurave të prokurimit, duke përfshirë mungesën e hartimit të projektit ekzekutiv për projektet specifike.

Ndikimi

Mungesa e projektit ekzekutues mund të shkaktoj vështirësi në realizimin e projekteve gjatë fazës së ekzekutimit dhe rritë rrezikun që gjatë procesit të ekzekutimit të projekteve të paraqiten pengesa të ndryshme si në aspektin profesional, ashtu edhe në vonesat e punimeve apo edhe në rritjen e kostove të projekteve.

Rekomandimi B2

Kryetari të sigurojë forcimin e kontrolleve dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2024, ishin 1,560,705€, përderisa ishin realizuar 1,701,663€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë 383,330€, të hyrat nga lejet e ndërtimit 547,104€, taksat administrative 683,145€, të hyrat shfrytëzimi i pronës publike dhe qiraja 87,139€ dhe tjera 845€.

Çështja A5 - Mos raportim i rregullt për shfrytëzim të pronave komunale

- Gjetja** Neni 22 paragrafi 2 i Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, përcakton se “Kryetari i Komunës obligohet që në raportet e tij të rregullta gjashtë (6) mujore t’i paraqet Kuvendit të Komunës edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, deri në fillimin e implementimit dhe arritjes së qëllimit të dhënies së pronës në shfrytëzim”.
- Kryetari i Komunës nuk kishte paraqitur asnjë raport periodik gjashtëmujor Kuvendit Komunal lidhur më monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme.
- Shkak i ndodhjes është mosrespektimi i kërkesave ligjore në lidhje me raportimin dhe mbikëqyrjen e kontratave për shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.
- Ndikimi** Mungesa e raportimit për monitorimin e kontratave për pronat komunale të dhëna në shfrytëzim përveç se krijon pa pajtueshmëri ligjore ndikon në transparencën dhe realizimin e plotë të të hyrave.
- Rekomandimi A5** Kryetari duhet të sigurojë se raportet rregullta gjashtë (6) mujore të përmbajnë edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Mangësi në databazën e tatimit në pronë

- Gjetja** Ligjin nr. 08/L-224 për ndryshimin dhe plotësimin ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme neni 3 dhe Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 11 pika 1 definojnë:” Zbritja për vendbanimin parësor- Personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit, para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejohet zbritja prej 30,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit. Po ashtu, Ministria e Financave përkatësisht Departamenti i Tatimit në Pronë ka njoftuar komunat për vendimin e marr për regjistrimin e numrit personal në rastin e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005, kjo me qëllim të shmangies së duplikimeve/apo parregullsive dhe sigurimin e zbatimit efektiv të këtij neni.

Nga analiza e bazës së të dhënave për tatimin në pronë të siguruar nga komuna, kemi vërejtur se 148 persona kishin përfituar zbritje të tatimit në pronë pa numër personal.

Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme në departamentin e tatimit në pronë.

Ndikimi

Vlerësimi i njësive rezidenciale me zbritje pa numër personal mund të rezultojë me kalkulim të parregullt të zbritjes apo shmangie nga tatimi në pronë, ku për pasojë komuna pranon më pak të hyra nga kjo kategori. Për më tepër, regjistrimi i numrave personal, garanton informata më të sakta dhe të besueshme në regjistrin e tatimit në pronë.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të marrë veprime shtesë për të siguruar se janë bërë korigjimet e nevojshme në bazën e të dhënave të tatimit në pronë, në mënyrë që zbritja për vendbanim parësor të bëhet vetëm për personat fizik të cilët janë të regjistruar me numër personal dhe kanë deklaruar në komunë se objekti shërben si vendbanim parësor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 9,275,625€ prej tyre në vitin 2024 ishin shpenzuar 8,079,423€ që kanë të bëjnë me vendime gjyqësore përmbarimore, ndërtimin dhe rregullimin e infrastrukturës rrugore, ujësjellësit, rrjetin e kanalizimeve ndërtimin e parqeve dhe investime tjera kapitale, ku kemi hasur si në vijim:

Çështja B4 - Monitorimi i menaxhimit të kontratave jo përmes E-Prokurimit

Gjetja	<p>Paragrafi 70,24.f. i Rregullores nr.01/2022 për Prokurimin Publik parasheh se “Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik”.</p> <p>Menaxheret e kontratave/projekteve nuk kanë mbajtur dhe arkivuar menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktueseve përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.</p> <p>Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme.</p>
Ndikimi	<p>Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikoj në një menaxhim jo të mirëfilltë të kontratave si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti të marr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.</p>
Rekomandimi B4	<p>Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.</p>

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Pasuritë jo financiare të shpalosura në PFV-të e vitit 2024 ishin për: pasuritë kapitale mbi 1,000€ në vlerë 528,864,612€ pasuritë jo kapitale nën 1,000€ në vlerë 454,130€ dhe stoqet në vlerë 126,214€, ku kemi hasur si në vijim:

Çështja A6 - Mangësi në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare

Gjetja Rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, neni 19.4.3 përcakton se: “Çdo fundvit bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare, tutje neni 21 i kësaj rregulloreje ka përcaktuar kërkesat për vlerësimin e pasurive jo financiare”, po ashtu neni 11.3 përcakton se: “Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet dhe zhvlerësimi”.

Komuna ka kryer procesin e inventarizimit të pasurive jo financiare, mirëpo nuk kishte bërë krahasimin (harmonizimin) e gjendjes së inventarizuar me gjendjen e pasurive në regjistrat kontabël, rrjedhimisht nuk dihet diferenca në mes gjendjes së kontabilitetit dhe inventarizimit. Poashtu nga raportet e vlerësimit të pasurive jo financiare kanë rezultuar në pasuri jo financiare jashtë përdorimit dhe të dëmtuara, si pasoj që akoma nuk ishte formuar komisioni për tjetërsimin e pasurive që do të rezultonte në përgatitjen e raportit për pasuritë që duhet të largohen nga përdorimi dhe në përditësimin e regjistrave kontabël. Gjithashtu duhet të theksojmë se nga analiza e shpalosjes dhe të dhënave të pasurive jo financiare kapitale mbi 1,000€ në PFV kemi vërejtur se akoma ka të regjistruara në kategorinë investime në vijim për vitet 2014 deri në vitin 2023 në vlerë totale 4,616,410€ të cilat përkundër që mund të jenë në përdorim akoma mbahen në regjistra si pasuri në vijim.

Kjo gjendje ishte për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme lidhur me zbatimin e kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare.

Ndikimi Mos krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare dhe mos regjistrimi i procesit të përmbylljes së investimit kapital ndikon në saktësinë, plotësinë dhe vlerësimin si rezultat i mos aplikimit të zhvlerësimit për investimet në vijim.

Rekomandimi A6 Kryetari, duhet të sigurojë se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat, si dhe zbatimin e drejtë të kontrolleve të brendshme lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare kapitale sipas klasifikimit kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme të shpalosura në PFV-të ishin në vlerë 4,739,225€, ku ato kishin të bëjnë me tatimin në pronë në vlerë 2,036,024€, taksa në biznes 1,795,263€, qiraja nga shfrytëzimi i pronave 888,348€ dhe tjera 19,590€, ku kemi hasur si në vijim:

Çështja A7 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesën, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Arkëtimi i të hyrave tjera duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave.

Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në inkasimin e llogarive të Arkëtueshme (LIA) pasi që vazhdon rritja e tyre nëpër vite. Për mostrat tona nuk kemi vërejt që komuna ka marr ndonjë veprim konkret për vitin 2024 për inkasimin e LIA. Pjesëmarrjen më të madhe e kanë të arkëtueshmet ishte nga tatimi në pronë 2,036,025€, taksat për ushtrimin e veprimtarisë 1,795,263€, shfrytëzimi i dhënies së pronës publike (qiraja) 888,348€ dhe të tjerat 19,590€.

Dobësitë e identifikuara lidhur me llogaritë e arkëtueshme janë për shkak të kontrolleve të brendshme jo efektive në menaxhimin përkatësisht inkasimin e tyre.

Ndikimi Mos inkasimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin komunal dhe reflekton negativisht në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetanake.

Rekomandimi A7 Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rritjes së efikasitetit në inkasimin e llogarive të arkëtueshme, duke mos përjashtuar edhe masat juridike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	20,968,992	24,743,446	23,271,466	21,603,045	17,510,741
Grante Qeveritare - Buxheti	19,408,287	20,228,734	19,245,501	18,024,090	14,981,037
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	127,905
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,233,347	1,106,748	1,597,939	957,593
Të hyrat vetanake	1,560,705	2,160,705	1,800,834	1,580,064	939,348
Donacionet vendore	0	2,213	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	1,118,448	1,118,383	400,953	504,858

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 3,774,454€. Kjo rritje është rezultat i Vendimit të Qeverisë, i bartjes së të hyrave vetjake nga viti paraprak, I tejkalimit të planifikimit të hyrave, I rezervës, si dhe donacioneve.

Komuna ka shpenzuar 94% të buxhetit final ose 23,271,466€, por duhet të theksojmë se gjatë vitit 2024, komunës përmes vendimeve gjyqësore/përmbartimore ju kanë ekzekutuar mbi rreth 3.5 €milon nga kategori të ndryshme ekonomike.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	20,968,992	24,743,446	23,271,466	21,603,045	17,510,741
Pagat dhe mëditjet	11,031,827	11,852,274	11,851,852	10,909,740	9,671,999
Mallrat dhe shërbimet	2,711,434	2,756,112	2,502,429	2,426,270	2,143,765
Komunalitë	348,449	350,997	334,770	315,379	275,283
Subvencionet dhe transferet	493,000	508,439	502,992	458,415	413,004
Investimet Kapitale	6,379,282	9,275,625	8,079,423	7,493,242	5,006,690
Rezervat	5,000	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 820,447€, krahasuar me buxhetin fillestar. Kjo rritje vjen nga Vendimi i Qeverisë së Kosovës nr. 03/239 i datës 24.12.2024, për mbulimin e pagave që janë paguar përmes vendime gjyqësore përmbarimore për pagat jubilarë.

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 44,678€. Kjo rritje vjen nga rritja e tejkallimit të planifikimit për të hyra në vlerë 13,094€, si dhe nga bartja e të hyrave vetjake nga viti 2023 në vlerë 31,584€.


Buxheti final për komunalit ishte rritur për 2,548€. Kjo rritje vjen nga bartja e të hyrave vetjake nga viti 2023.

Buxheti final për subvencione ishte rritur për 15,439€, Kjo rritje vjen nga bartja e të hyrave vetjake nga viti 2023.

Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,896,343€.

Kjo rritje vjen nga rritja e tejkallimit të planifikimit për të hyra në vlerë 586,906€, nga bartja e të hyrave vetjake nga viti 2023, në vlerë 1,183,776€, si dhe nga donacionet në vlerë 1,120,661€, nga rezerva në vlerë 5,000€. Shpenzimi i buxhetit për këtë kategori ishte rreth 87%, por duhet të theksojmë se vlera prej 1,879,133€, ishte ekzekutuar për kontratën kolektive që i takon kategorisë paga dhe mëditje.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2024, ishin planifikuar 1,560,705€, përderisa ishin realizuar 1,701,663€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga qiraja etj. Po ashtu, komuna për vitin 2024, ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku dhe gjobat e gjykatës në vlerë totale prej 926,065€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministritë e linjës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	1,560,705	1,560,705	1,701,663	1,982,661	1,509,673
Të hyrat tatimore	937,615	937,615	383,330	927,166	674,100
Të hyrat jo tatimore	623,090	623,090	1,317,488	1,051,559	835,572
Të hyrat tjera	0	0	845	3,936	

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023 ka rezultuar në pesë (5) rekomandime kryesore. OB kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, një (1) rekomandim ishte zbatuar, ndërsa katër (4) nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të ndërmarrë masa për të siguruar funksionimin e plotë të kontrolleve që kanë të bëjnë me përgatitjen e paramases dhe parallogarisë.	Nuk kemi hasur raste të tilla.	I zbatuar
2.	Të hyrat	Kryetari duhet të marrë veprime shtesë për të siguruar se janë bërë korrigjimet e nevojshme në data bazën e tatimit në pronë, në mënyrë që zbritja për vendbanim parësor të bëhet vetëm për personat fizik të cilët janë të regjistruar me numër personal dhe kanë deklaruar në komunë se objekti shërben si vendbanim parësor.	Nuk janë ndërmarrë masat e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatim
3.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme) dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Edhe në vitin 2024 komuna kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve.	Nuk ka filluar zbatim
4.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos iniciohen procedurat pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues, të cilat do të ndikonin në eliminimin e vonesave dhe të kostove shtesë.	Edhe këtë vitë ka prokurime në mungesë të projekteve ekzekutive.	Nuk ka filluar zbatim
5.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.	Edhe në vitin 2024 menaxhimi i kontratave nuk bëhet përmes platformës së e-prokurimit.	Nuk ka filluar zbatim

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Hysen Boqolli, Udhëheqës i ekipit



Fetah Osmani, Anëtar i ekipit



Arbresha Breznica Rama, Anëtare e ekipit



Granita Zenelaj, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVË
KOMUNA GILGOC
MUNICIPALITY
CI N° 400/01-19824
M. 30/05/2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Gillogocit, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Ramiz Lladrovci

Kryetar i Komunës,

Data: 30.05.2025, Gillogoc,



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.